



**BASHKIA SARANDË
DREJTORIA EKONOMIKE**

Sarandë, më .03.2022

RELACION

**NIVELI I TE ARDHURAVE DHE TAVANET E SHPENZIMEVE NË NIVEL PROGRAMI,
TE PBA 2023-2025.**

***Drejtuar:* KËSHILLIT TË BASHKISË
SARANDË**

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për, "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor.

Në bazë të Planit Kalendar të Përgatitjes së PBA, miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë ***nr.226, datë 22.12.2021*** si dhe, *Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018* të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore, u parashikua ***nivelin e të ardhurave dhe tavanin e shpenzimeve publike***, në nivel programi, për periudhën afatmesme 2023-2025.

Në parashikimin e këtyre treguesave të rëndësishëm të ***Programit Buxhetor AM 2023-2025***, u mbështetëm në ***infrastrukturën ligjore e n/ligjore përkatëse të MFE*** në metodologjinë e planifikimit prognozë si dhe në ecurinë e realizimit faktik gjatë periudhës 2020-2021. Gjithashtu u jemi referuar niveleve të parashikuar në buxhetin AM vendor 2021-2023 si dhe, në rekomandimet e udhëzimet e strukturave përkatëse të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Përcaktimi i nivelit të të ardhurave sipas zërave e burimeve të krijimit si dhe i ***tavaneve limit të shpenzimeve publike në nivel programi***, përbëjnë domosdoshmëri për një zhvillim të qëndrueshëm afat-mesëm vendor.

Programit Zhvillues Afatmesëm 2022-2024 projektton pritshmëritë në zhvillimet makro-ekonomike të njësisë vendore në horizontin kohor afat-mesëm si dhe parashikon nivelin e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore, në nivel programi. Përcakton gjithashtu, synimet e politikat e vetqeverisjes vendore në lidhje me treguesit kryesorë të zhvillimit vendor e të politikës fiskale, pritshmëritë ekonomike për vitin aktual 2022 si dhe për tre

vitet e ardhshëm 2023-2025. Treguesit që janë programuar në draft-programin e paraqitur do të jenë sërish subjekt **rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit në vijim 2022**, përpara finalizimit të PBAM të rishikuar. Hartimi i këtij dokumenti nga ekzekutivi vendor shërben për të bërë me dije Këshillin Bashkiak dhe komunitetin vendor lidhur me ***mundësitë potenciale zhvilluese të njësisë vendore*** për tri vitet e ardhshme.

Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- ✓ Qendrueshmeria ekonomike pas rikuperimit nga recesioni që pesoi gjatë vitit 2020, nepermjet harmonizimit të politikave makroekonomike me politikat vendore.
 - ✓ Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
 - ✓ Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:
- Një planifikim i qëndrueshëm afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
 - Forcimi i lidhjes mes programeve të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- ✓ Percaktimi i objektivave, nepermjet Planeve zhvilluese strategjike.
- ✓ Krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve politike, të shprehura në programin politik të Bashkisë së Sarandes, dhe prioriteteve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
- ✓ Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare);
- ✓ Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;

Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet dhe objektivat për çdo program.

PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë duke u fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave prioritare të komunitetit të ndërthurura me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet:

- a. *Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes)*
- b. *Shpenzimet kapitale.*

Njësitë Shpenzuese:

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Sarandes
- b. Institucionet e varësisë

Për ti paraprirë gjithë procesit zhvillues trivjeçar 2023-2025, paraprakisht **parashikohen e miratohen nivelin e te ardhurave vendore dhe tavanet e shpenzimeve buxhetore në nivel programi**. Kjo bën të domosdoshëm dhe kërkon nevojën e **kostimit të politikave zhvilluese** sipas sektorëve e fushave të veprimtarisë vendore. **Tavanet e** shpenzimeve publike hartohen mbi bazën e historikut dhe të analizës të ecurisë së shpenzimeve faktike në periudhen trevjeçare. Në gjithë këtë proces merr rëndësi të veçantë **përcaktimi i drejtë i burimeve** vendore nga taksat dhe tarifast vendore, si edhe atyre të mbështetura nga burimet qëndrore e alternative.

Nga analiza e ecurisë së dinamikës së zhvillimit të burimeve vendore evidentohet qasje pozitive e rritjes së nivelit të tyre nga një viti në tjetrin duke rritur në këtë mënyrë edhe shanset për një situatë makro-ekonomike gjithnjë e më premtuese e zhvilluese mbi bazen e te ciles eshte bere edhe parashikimi i Tavanëve buxhetore per periudhen afatmesme.

TE ARDHURAT DHE PARASHIKIMI PARAPRAK I TAVANEVE PER SHPENZIMET PUBLIKE VENDORE PER PERIUDHEN AFATMESME 2023-2025

I. Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Sarande për vitet 2023-2025

Politikat fiskale do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorin e turizmit. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi në tre vitet e fundit. Rritja e të ardhurave është synuar kryesisht nga zgjerimi i bazës së tatueshme, lufta ndaj informalitetit dhe përmirësimi i administrimit tatimor. Në këtë program buxhetor për vitet 2023-2025 synohet shpërndarja në mënyrë më të drejtë e barrës fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Përcaktimi real i kapaciteteve të burimeve vendore shërben për të projektuar sa më drejt potencialet zhvilluese afatmesëm, të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kjo na mundëson hapa të sigurtë e të qëndrueshëm për hartimin e një **programi real zhvillimi**, i cili do të garantojë zgjerimin dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të inputeve vendore.

Metoda e parashikimit të nivelit të të ardhurave në planin afatmesëm janë bazuar në:

- a. *Trendi i realizimit të të ardhurave në 3 vitet e fundit.*
- b. *Zgjerimi i bazës së kapaciteteve fiskale bazuar në politikat makroekonomike dhe vendore për orjentimin e zhvillimit ekonomik.*
- c. *Parashikimi i ecurisë së kapaciteteve fiskale për tarifast e perkohshme bazuar në zbatimin e PPV.*

Realizimi faktik i vitit 2021 është 3.2% më i lartë se në vitin 2020, duke bërë parashikimin afatmesëm me inkurajues në rishikimin e niveleve të programuara të të ardhurave në buxhetin afatmesëm të miratuar 2023-2025. Programi afatmesëm i përditësuar mbështet më fuqishëm zhvillimin e integruar territorial të njësisë vendore dhe të zonave juridike administrative. Me përparësi ai mbështet, zbatimin e politikave të **pushtetit vendor** në fushën e **investimeve** e të **shërbimeve publike**, në fushën e **zhvillimit të industrisë turistike**

e të politikave fiskale e sociale. Buxheti është i balancuar. Midis të ardhurave dhe shpenzimeve publike është vendosur dhe egziston një korelacion funksional.

Programi ekspozon **rritje të transparencës** së krijimit e të angazhimit të burimeve publike, **përmirësim të performancës së kapaciteteve administrative e të barazisë gjinore.**

Niveli i Te ardhurat vendore, për periudhën **afatmesme 2023-2025**, është mbështetur në realizimin parashikimit ne zerin e taksave dhe tarifave per periudhen 2020-2021 , në **paketën fiskale e në buxhetin e miratuar per vitin 2022**, si edhe **zbatimi i PPV**, duke reflektuar ndryshimet e pasqyruara ne politikat fiskale vendore. Nga përditësimi i kryer, efektet në rritjen e burimeve vendore të të ardhurave , për të tre vitet e ardhshme jane parashikuar me rritje prej *61 milione leke* arrijnë, mesatarisht *20 milion lekë*, në vit. Për të qënë sa më afër realitetit është mbajtur parasysh edhe **realizimi faktik i burimeve, në dy vitet e fundit 2020-2021 si dhe i pritshmi i vitit 2022**. Për të krijuar një vizion më të plotë mbi ecurinë e burimeve vendore sipas viteve, në periudhën afatmesme 2023-2025, po japim më poshtë një tabelë përmbledhëse të të ardhurave.

Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë e Sarandes, përbëhen nga:

1. Të ardhurat e veta:
2. Transferta e pakushtëzuar.
3. Transferta e kushtëzuar.

Tabela1. Parashikimi i te ardhurave per periudhen 2023-2025

Nr	Emërtimi	Sipas viteve					Rritja 25/20 ne %
		V. 2021	V. 2022	V. 2023	V. 2024	V. 2025	
		Fakt	Parashik	Parashik	Parashik	Parashik	
1	Të ardhurat nga taksat	273,721	302,500	319,600	336,400	344,000	14.4
2	Të ardhurat nga tarifat	133,169	130,150	145,850	148,400	148,400	35.9
3	Të ardh.të tjera	38,724	17,350	14,350	14,450	14,450	-32.5
A.	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat	445,614	450,000	479,800	499,250	506,850	17.5
B	<i>Të ardh. t' trashg. viti kaluar</i>	<i>248,673</i>	<i>230,000</i>	<i>149,000</i>	<i>153,000</i>	<i>150,500</i>	-14.1
I.	Totali te ardhurat e veta & trashg.	694,287	680,000	628,800	652,250	657,350	8.4
4	Transferta e pakusht.	145,312	134,873	145,663	156,361	167,120	29.4
5	Transferta specifike	103,707	109,560	112,800	113,800	116,300	12.1
6	transferta e kushtezuar	329,360	370,655	466,534	389,000	404,000	72.8
II.	<i>Transfertat nga Buxh.Nac.</i>	<i>578,379</i>	<i>615,088</i>	<i>724,997</i>	<i>659,161</i>	<i>687,420</i>	47.3
	Totali I Buxhetit	1,272,666	1,295,088	1,353,797	1,311,411	1,344,770	25.3

Grafik 1. Ecuria e realizimit vjetor te burimeve buxhetore.




Tabela e mesiperme paraqet rritjen dhe kontributin sipas zerave te te ardhurave dhe ecurine nga viti ne vit . Ne vitin 2021 jane realizuar te ardhurat e veta 3,3% me shume se 2020, ne vitin 2022 3% me lart se realizimi i vitit 2021 , per vitin 2023 jane parashikuar te ardhurat e veta me 6,2% me shume, ne vitin 2024 jane parashikuar ne 4% me te larta krahasimisht me vitin 2023, ne vitin 2025 jane parashikuar ne 2% me lart se ne vitin 2024.

E pare ne prespektive ne vitin 2025 jane parashikuar *te ardhurat vendore* ne rritje me rreth 17,5% krahasimisht me vitin 2020. Persa u perket te ardhurave totale parashikimi afat mesem eshte bere ne rritje me rreth 25,3% krahasimisht me vitin 2020.

Për mbledhjen e të ardhurave janë përcaktuar strukturat përkatëse, si më poshtë:

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Strukturat e Aparatit të Bashkisë;
- Agjentët tatimorë

Në mënyrë të detajuar të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për parashikimin e vitit 2023-2025 në Bashkinë e Sarandes, paraqiten si më poshtë:

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, ë) taksa të tjera, të përcaktuara meligj.

Nga analiza e strukturës së burimeve vendore arrihet në përfundim se të ardhurat nga taksat vendore zënë një peshë të konsiderueshme e përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave vendore ne 67% te totalit. Në vitin 2022 niveli i të ardhurave nga taksat është parashikuar **302,500 mije lekë**, me një rritje relative, midis dy periudhave, me rreth **14.4 %** . Megjithë


luhatjet e lehta në strukturë, te ardhurat nga taksat, mbeten edhe për periudhën në vazhdim, burim mjaft i rëndësishëm e me ndikim, në përmirësimin e performancës së financave lokale.

Tabela 2. Te ardhurat nga taksat vendore

Ecuria vjetore e taksave vendore							
	Periudha kohore	Fakt 2020	Fakt 2021	Parashik 2022	Parashik 2023	Parashik 2024	Parashik 2025
	Të ardhurat nga taksat	300,668	273,721	302,500	319,600	336,400	344,000

Pesha e te ardhurave nga taksat eshte 67,8% te te ardhurave vendore, tregues ky qe e ben

Grafiku.2 Parashikimi afatmesem i taksave



Taksa mbi ndertesat ze rreth 32% ne burimet vendore kundrejt 22% qe zinte ne vitin 2020 dhe me nje prespektive prej 35% ne vitin 2025. Kjo deshmon se taksa mbi pasurine eshte taksa me e rendesishme, e qendrueshme dhe me peshe me te madhe specifike ne te ardhurat vendore nga taksat.

Prioritar eshte saktesimi i te dhenave per bazen e taksueshme nepermjet kadastres fiskale, rritja e kapacitetit fiskal nga kjo takse eshte e sigurt.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture eshte taksa e dyte per nga ndikimi ne buxhetin vendor dhe ze rreth 24 % te te ardhurave nga taksat e bashkise. Planifikimi i te ardhurave nga kjo takse eshte i luhatshem pasi edhe realizimi nga viti ne vit ka qene e tille ne varesi te zbatimit te PPV ne territorin e Bashkise dhe njesise administrative. Parashikohen ne periudhen afatmesme te moderohet vlera e takses se infrastruktures me taksat e tjera ne menyre qe ne periudhat e mungeses ne buxhet, mos te kete ndikimin e deficitit te realizimit te te ardhurave.

Taksa e fjetjes ne hotel eshte gjithashtu takse premtuese per te ardhurat e Bashkise me rreth 8% te totalit te taksave. Ritja e parashikuar ne programin afatmesem eshte e moderuar .Ne parashikimin e saj jane marre parasysh realizimi i buxhetit 2021 nen ndikimin e faktoreve te jashtem ne turizem dhe sektoret e tjere te ekonomise rajonale dhe globale.Turizmi eshte sektori me prioritar i ekonomise vendore per Saranden duke bere qe kjo taksete jete burim i genesishmem i buxhetit vendor.

Taksa e zenies se hapësirës publike perben rreth 20% te totalit te buxhetit nga taksat vendore. Perbehet kryesisht nga dhenia me qera e hapësirave publike ne periudhen e veres ne vijen bregdetare, Ka ardhur ne rritje si pasoje e shtimit te siperfaqeve te plazheve nga sipermarresit private por te kontraktuar nga pushteti vendor dhe agjensite perkatese shtetetrore.Ne fund te periudhes afatmesme eshte parashikuar me shtese deri ne 8,500 mije lek.

Taksa vjetore e mjeteve te perdorura eshte nje takse e ndare, e transferuar nga DRTRSH ne reference me numurin e mjeteve te perdorura ne Bashkine e Sarandes, duke perfituar 25% te te ardhurave te gjeneruara nga totali i kesaj takse. Ne progresion parashikimi eshte me rritje duke pasur parasysh ndryshime te mundshme ligjore dhe rritjen e numrit te mjeteve te transportit.

Tabela 3 . Ecuria e taksesve kryesore ne buxhetin e Bashkise.

ne 000/lek

Ecuria dhe kontributi i taksave kryesore							
Nr	Periudha kohore	Fakti2020	Fakt 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025
1	Taksa e fjetjes në hotel	11,070	24,000	25,500	26,500	27,000	28,000
2	Taksa mbi ndërtesat,pronën	67,978	90,000	95,500	96,000	98,000	120,000
3	Taksa e dik.infra.ndërt. reja	113,920	73,000	74,000	70,500	70,000	65,000
4	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	23,584	19,000	24,000	24,500	25,000	26,000
5	Taksa për zënien hapës. publike	54,120	51,000	47,000	47,500	48,000	68,500

A.2 Tarifat vendore.

Struktura e burimit te te ardhurave vendore ne vitet e fundit ka krijuar nje stabilitet pothuajse te qendrueshem ndikuar nga faktore te nryshem makroekonomike dhe politika vendore nderthurur edhe me natyren ekonomike te Bashkise Sarande. Per kete arsye ne PBA 2023-2025 niveli i perqindjes ne strukturen e pergjithshme te te ardhurave perben rreth 29% te totalit. Dhe pothuajse eshte e pandryshueshme ne rritje me nivelin e te ardhurave pasi rritjet jane propocionale ne te njejtin nivel.

Rritja e tarifave ne periudhe afatemesme eshte parashikuar ne nivelin 14% ne raport me vitin 2022. Ndikimin me te madh ne rritjen e ka tarifa e sherbimeve publike qe parashikohet te zgjerohet baza e taksueshme krahasimisht per te ruajtur ndryshimin e nivelit te tarifave ne rritje qe do te shtonte barren fiskale te popullates.

Në te ardhurat nga tarifat vendore, siç pasqyrohet në tabelën përkatëset, peshën kryesore e zënë te ardhurat nga **tarifa e shërbimeve publike**, me 66% e totalit për pastrimin, gjelbrimin dhe ndriçimin. Megjithë përmirësimet, pesha e të ardhurave nga tarifat , në strukturën e burimeve vendore, vazhdon të jetë nën mundësitë potenciale. Kapaciteti mbulimit te koston se sherbimit nga kjo takse eshte ne nivele te uleta pothuajse ne rreth **65 % e** koston së shërbimeve publike që njësia vendore ofron në komunitet. Për ndriçimin mbulohen me tarifën e vendosur më pak se **40 %** e koston së shërbimit. Politikat vendore ne periudhen afatmesme dhe niveli ekonomik i bashkise ne teresi do te zbusse nivelin e koston se sherbimeve te pambuluara me tarifat perkatese.

Tabela 4. Parashikimi afatmesem i tarifave vendore

Ecuria vjetore e tarifave vendore							
	Periudha kohore	Fakt 2020	Parashik 2021	Parashik 2022	Parashik 2023	Parashik 2024	Parashik 2025
1	Të ardhurat nga tarifat vendor	109,213	133,169	130,150	145,850	148,400	148,400

Parashikimi me rritje është bërë edhe në zerat e tjere të tarifave por në shifra me të moderuara, për vetë natyrën e tyre të pandryshueshme.

Tabela 5. Ecuria e tarifave vendore në periudhën afatmesme

Ecuria dhe kontributi i taksave kryesore							
Nr	Periudha Kohore	Fakti V. 2020	Fakti V. 2021	Parashikimi V.2022	Parashikimi V.2023	Parashikimi V.2024	Parashikimi V.2025
1	Tarifa për shërb.pastrim,gjelb.ndriç.etj	68,000	88,512	80,950	80,950	80,950	80,950
2	Tarifa për hapësira publike	2,000	2,000	4,950	4,000	4,600	4,600
3	Tarifa për shërbimin e ndriçimit	6,000	6,000	6,000	17,500	17,900	17,900
4	Tarifa për shërbimin e gjelberimit	6,117	7,000	7,000	8,000	8,500	8,500
5	Tarifë parkimi mjete	1,608	1,552	2,500	2,800	2,950	2,950
6	Tarifë për shërb.të ndryshme administ.	16,542	17,317	20,000	17,500	18,000	18,000
7	Tarifë për shërb.sociale(arsim.konv).	6,646	9,188	6,400	12,700	13,050	13,050

a. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Tarifës së Pastrimit është tarifa më e madhe në strukturën e tarifave vendore me rreth 66% të totalit. Kësaj tarife i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Sarandës. Parashikimi në buxhetin afatmesëm 2023-2025 është bërë duke mbajtur parasysh ecurinë në rritje për dy vitet e kaluara si pasoje e ndryshimeve të bazës ligjore, dhe të zgjerimit të bazës së taksimit dhe si rezultat i riorganizimit të mënyrës së mbledhjes së taksës e forcimit të strukturave menaxhuese.

b. Tarifa për shërbime të tjera administrative

Kategoria e Tarifave të vendosur për shërbime të tjera administrative, përfshin shërbimet e dhëna nga Bashkia me pagesë duke përfshirë pagesat për leje pune nga ana e drejtorisë së shërbimeve, vertetime dhe dublikata të dhëna nga drejtoria e urbanistikës, tarifa për vulosjen e veterinarëve të bagetive të therura, tarifa e lishensimit të veprimtarive të transportit, tarifa e parkimit për mjete të licensuara dhe vendparkimet publike, tarife për

pyjet dhe kullotat, tarife per sherbim shtese nga zjerrfikesja, tarife per trajtimin e mbetjeve inetre ne landfille.

Ne strukturen e buxhetit nga tarifat vendore kjo kategori tarifash ze rreth 13 % .

c. Tarifa te institucioneve te arsimit ,kultures,sportit

Ne strukturen e buxhetit te tarifave ze rreth 8% te totalit te tarifave. Ne kete ze te ardhurash perfshihen te ardhurt nga muzeumet, mencat e konviktit, te kopeshteve dhe cerdheve, biletat e sportit dhe te pallatit te kultures. Per periudhen 2023-2025 eshte bere parashikimi me rritje nga viti ne vit, objektiv dhe duke marre parasysh faktoret qe ndikojne ne ndryshimin e baze se tarifimit.


- ✓ Transfertat nga Buxheti i Shtetit .
- ✓ Transferta e Pakushtëzuar.

Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor sipas formulës së paraqitur në ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" si dhe udhëzimeve plotësues. Transferta e pakushtëzuar për Bashkinë e Sarandes në periudhën 2020 – 2025 paraqitet si vijon:

Tabela 6. Te ardhurat nga transferta e pakushteuar dhe transferta e sektoriale

Transfertat e pakushtezuara dhe ecuria vjetore ne periudhen afatmesme						
Periudha kohore	Fakt 2020	Fakt 2021	Parashik 2022	Parashik 2023	Parashik 2024	Parashik 2025
Transferta e pakushteuar	129,131	145,312	134,873	145,663	156,361	167,120
Transferta e pakushteuar sektoriale	103,707	103,707	109,560	106,800	106,800	106,800

Grafiku 3. Parashikimi i transferes se pa kushteuar dhe transferes sektoriale



- ✓ **Transferta e pakushtëzuar.** Parashikimi i Transfertes se pakushtezuar nga Buxheti i Shtetit është bazuar në ecurinë progresive të viteve të fundit. Në vitin 2025 krahasimisht me vitin 2022 rritja është parashikuar 23,9%. Transferta përbën 14.5% të të ardhurave. Transferta e pakushtëzuar duhet t'u sigurojë Njësive të Qeverisjes Vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Në vitin 2021, ashtu sikurse edhe në vitin 2020, transferta e pakushtëzuar do të përdoret për financimin e shpenzimeve operative dhe kapitale, e ndarë respektivisht në 40 % për shpenzimet kapitale dhe 60% për shpenzimet operative.

✓ **Transferta e pakushtezuar sektoriale**

Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" do të vazhdojnë të financohen nëpërmjet transfertës se pakushtezuar sektoriale edhe në buxhetin e vitit 2022. Programet e financuara nga transferta e pakushtezuar sektoriale janë parashikuar me rritje deri në 6,1% në periudhën afatmesme bazuar kjo në alokimin e fondeve për progresionin e viteve të kaluara. Programet e financuara:

- Personeli edukativ dhe mbështetës në arsimin parashkollor
- Personeli mbështetës i arsimit para-universitar
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri
- Shërbimi pyjor
- Ujitja dhe kullimi
- Mbrojtja civile

✓ **Fondi i Zhvillimit të Rajoneve**

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor. Ky fond përfitohet për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë njësitet e qeverisjes vendore, në fushat e infrastrukturës rrugore vendore, arsimit, etj. Projektet miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, mbi bazën e politikave dhe programeve të Zhvillimit të Rajoneve të Shqipërisë i cili përcakton edhe masën e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitet e qeverisjes vendore. Nisur edhe nga projektet e miratuara për financim parashikimi afatmesëm për programet në investimet publike janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 7. Te ardhurat nga transferta e kushtezuar për investime

Transfertat e kushtezuara për investime dhe ecuria vjetore në periudhën afatmesme						
Periudha kohore	Fakt 2020	Fakt 2021	Parashik 2022	Parashik 2023	Parashik 2024	Parashik 2025
Transferta e kushtezuar për investime	13,273	112,183	152,655	237,634	160,000	175,000

Parashikimi i buxhetit per investime me financim FSHZH eshte vetem per projektet e zbatuara nga Bashkia, por financime behen edhe me procedurat nga Ministria e linjes duke bere qe bashkia te jete vetem perfituesja e investimit ne fund te projektit.

II. TAVANET E SHPENZIMEVE PUBLIKE VENDORE 2023-2025

Per shpërndarjen e burimeve dhe përcaktimin e taveve buxhetore per cdo program buxhetore GMS eshte bazuar në realizimin faktik te viteve 2020-2021 dhe ne parashikimin e pritshëm për vitin 2022. Parashikimi i fondeve buxhetore mbështet kryesisht në burimet e brendshme vendore si dhe, në transfertat nga buxheti qëndror e burime të tjera alternative duke i dhene **përparësi investimeve në shërbimet publike**. Përcaktimi i drejtë i burimeve vendore dhe i atyre alternative kushtëzojnë edhe kapacitetet zhvilluese vendore për periudhën afatmesme 2023-2025. Përditësimi i burimeve imponojnë gjithashtu edhe përditësimin **e taveve të shpenzimeve** publike në nivel programi. Mbi bazë të taveve të përkohshme të miratuara, është kryer shpërndarja e shpenzimeve për cdo program buxhetor, si dhe janë përcaktuar kërkesat shtesë buxhetore për përmirësime e devijime të nevojshme. Procesi i shpërndarjes së fondeve buxhetore për cdo funksion dhe kompetencë për periudhën afatmesëm 2022-2024, është realizuar ne bazë të objektivave që synohen për cdo program buxhetor.

Në parashikimet e burimeve është përfshirë edhe fondi që do të mbartet nga viti ne vit. Fondet e mbartura përbëjnë fondet e papërdorura në vitin respektiv të arkëtimit të tyre, ku përfshihen të ardhurat nga dy burime financimi, të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar.

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Sarandes për vitet 2023-2025, parashikohen të ndara sipas programeve buxhetore si me poshte:

Tabela.8 Tavanet e Shpenzimeve e Bashkise Sarande sipas programeve 2023-2025

Tab nr.8/1

FUNKSIONI	KODI FUNK	KODI IPROGR AMIT	PROGRAMI	Fakt 2020			Fakt 2021			
				Shpenzim e korrente	Shpenzim e kapitale	Totali Shpenzime ve	shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzim e kapitale	Totali Shpenzime ve
Sherbime te pergjithshme publike	01	1110	Planifikim,menaxhim, Administrim	108,107		199,319	91,073	110,521	244,744	446,338
Rendi dhe siguria publike	03	3280	Shërbimi I mbrojtjes ndaj zjarrit	2,079		17,236	15,609	1,684		17,293
Ceshtjet Ekonomike	04	4240	Bujqesia, pyje, peshkimi	1,684		2,833	1,115	1,319		2,434
		4260	Administrimi Pyjeve	308		2,054	2,086			2,086
		4570	Infrastruktura dhe Transporti Rrugor		96,598	96,598				-
		10430	Çerdhja e Femijeve	1,367		12,152	11,342	3,244		14,586
Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	03	6260	Sherbime Publike Vendore	75,209	30,290	158,820	58,580	97,741		156,321
		6330	Ujesjelles, Kanalizime		8,490	8,490				-
Argerim,i Kultura, Feja	08	8130	Programe Kulturele & Sporti	1,238	2,803	21,717	17,556	4,277		21,833
Arsimi	09	9120	Arsimi parashkollor	11,364	44,807	113,943	59,372	14,514		73,886
		9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	477		3,235	3,295	992		4,287
		9240	Arsimi i mesem profesional	2,089		9,245	7,788	3,080		10,868
Mbrojtja sociale	10	10430	Shërbimi Social & ndihma ekon.t'ardh vet	916	4,853	8,086	1,851	960		2,811
		10430	Transf.Kusht.Soc & Paaftesi nga Buxheti	229,350		229,350		238,122		238,122
			Totali Shpenzimeve Publike	403,760	187,841	883,078	269,667	476,454	244,744	990,865

Tab. Nr 8/2

FUNKSIONI	KODI FUNK	KODI I PROGR AMIT	PROGRAMI	Plan 2022				Plan 2023			
				shpenzime personeli	Shpenzim e korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve	shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve
Sherbime te pergjithshme publike	01	1110	Planifikim,menaxhim, Administrim	135,917	181,561	201,270	518,748	135,917	187,514	7,379	330,810
Rendi dhe siguria publike	03	3280	Shërbimi I mbrojtjes ndaj zjarrit	16,846	2,153		18,999	16,846	2,350	3,500	22,696
Ceshtjet Ekonomike	04	4240	Bujqesia, pyje, peshkimi	1,984	4,592		6,576	1,984	7,300	-	9,284
		4260	Administrimi Pyjeve	2,195	521		2,716	2,195	2,750		4,945
		4570	Infrastruktura dhe Transporti Rrugor				-	-		187,860	187,860
		10430	Çerdhja e Femijeve	12,476	2,875		15,351	12,476	4,050		16,526
Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	03	6260	Sherbime Publike Vendore	63,900	139,710		203,610	63,900	117,400	75,884	257,184
		6330	Ujesjelles, Kanalizime			152,655	152,655	-	3,500	93,134	96,634
Argerim,i Kultura, Feja	08	8130	Programe Kulturele & Sporti	19,256	5,980		25,236	19,256	6,450	7,500	33,206
Arsimi	09	9120	Arsimi parashkollor	69,576	21,458	11,302	102,336	69,576		64,000	133,576
		9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	3,590	1,060		4,650	3,590		2,500	6,090
		9240	Arsimi i mesem profesional	8,296	6,650	3,775	18,721	8,296	6,650	3,550	18,496
Mbrojtja sociale	10	10430	Shërbimi Social & ndihma ekon.t'ardh vet	2,590	4,900		7,490	2,590	5,000		7,590
		10430	Transf.Kusht.Soc & Paaftesi nga Buxheti		218,000		218,000		228,900		228,900
			Totali Shpenzimeve Publike	336,626	589,460	369,002	1,295,088	336,626	571,864	445,307	1,353,797

Tab.nr8/ 3

FUNKSIONI	KODI FUNK	KODI I PROGR AMIT	PROGRAMI	Plan 2024				Plan 2025			
				shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve	shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Totali Shpenzimeve
Sherbime te pergjithshme publike	01	1110	Planifikim,menaxhim, Administrim	142,713	195,748	9,500	347,961	152,000	202,507	25,000	379,507
Rendi dhe siguria publike	03	3280	Shërbimi I mbrojtjes ndaj zjarrit	17,688	2,350	3,500	23,538	19,520	2,350	8,000	29,870
Ceshtjet Ekonomike	04	4240	Bujqesia, pyje, peshkimi	2,083	7,300		9,383	3,100	7,300	-	10,400
		4260	Administrimi Pyjeve	2,305	2,750		5,055	4,200	2,750		6,950
		4570	Infrastruktura dhe Transporti Rrugor	-		157,400	157,400	-	-	169,956	169,956
		10430	Çerdhja e Femijeve	13,100	4,050		17,150	13,100	4,050		17,150
Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	03	6260	Sherbime Publike Vendore	67,095	117,400	95,000	279,495	75,000	130,000	102,000	307,000
		6330	Ujesjelles, Kanalizime	-	3,500	80,306	83,806	-	3,500	10,000	13,500
Argerim,i Kultura, Feja	08	8130	Programe Kulturele & Sporti	20,219	6,450	11,000	37,669	20,219	8,200	12,368	40,787
Arsimi	09	9120	Arsimi parashkollor	73,055		14,000	87,055	80,100	-	20,000	100,100
		9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	3,770		2,500	6,270	6,000	-	-	6,000
		9240	Arsimi i mesem profesional	8,711	6,650	3,550	18,911	9,000	6,650	3,400	19,050
Mbrojtja sociale	10	10430	Shërbimi Social & ndihma ekon.t'ardh vet	2,720	6,000		8,720	3,500	6,000	6,000	15,500
		10430	Transf.Kusht.Soc & Paaftesi nga Buxheti		229,000		229,000		229,000		229,000
			Totali Shpenzimeve Publike	353,457	581,198	376,756	1,311,411	385,739	602,307	356,724	1,344,770

II.1 Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik


Parashikimi i fondeve buxhetore behet ne baze te klasifikimit ekonomik :

- + **Shpenzimet e Personelit** per administraten, punonjesit mbeshtetes dhe punetoret me kontrate te njesive ne varesi dhe ze mesatarisht rreth **26%** te buxhetit Total per periudhen afatmesme.
- + **Shpenzimet korrente** perbejne pjesen me te konsiderueshme ne buxhet me **45,5%** dhe perbehet prej shpenzimeve per sherbimet publike ne bashki, sherbimet kontraktuale per kopeshte shkolla dhe te gjitha institucioneve ne varesi te Bashkise si edhe detyrimet qe rrjedhin nga akte administrative etj.
- + **Shpenzimet kapitale**, me financim te brendshem dhe nga grantet, perbejne mesatarisht **28,5** te totalit te buxhetit. Ne perberjen e buxhetit zene rreth 54% burimet vendore dhe rreth 46% burime nga grandet qeveritare.

Tabela 9. Shpenzimet sipas natyres ekonomike

Tavani I shpenzimeve sipas natyres ekonomike ne periudhen afatmesme							
Shpenzime sipas klasifikimit		Fakti	Fakti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
		2020	2021	2022	2023	2024	2025
1	Shpenzime personeli	291,477	269,667	336,626	336,626	353,457	385,739
2	Shpenzime të tjera korrente	403,760	476,454	589,460	571,864	581,198	602,307
3	Shpenzime për Investime Kapitale	187,841	244,744	369,002	445,307	376,756	356,724
TOTALI		883,078	990,865	1,295,088	1,353,797	1,311,411	1,344,770

Grafiku 4. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Shpenzimet e personelit janë mbajtur në nivele të kontrolluara dhe kurba e rritjes së tyre është ne terma rrites per nga niveli i pages duke nisur na viti aktual dhe per periudhen afatmesme fondi i pages eshte parashikuar me 14% ne rritje. Persa i perket numrit te punonjesve eshte parashikuar rritje e moderuar ne sektorin e arsimit ku ka nevoja te vazhdueshme per punonjes mbeshtetes dhe edukatore per femijet me aftesi ndryshe. Deri në vitin 2025 fondet për shpenzime personeli, paga e sigurime shoqërore, rriten me **4.8 %** per cdo vit.

Në shtimin e shpenzimeve për personelin, për programin e arsimit parashkollor, është reflektuar edhe rritja e pages në këtë sektor vitin e kaluar.

Niveli i Shpenzimeve korente, operative e të mirëmbajtjes sipas programeve, është projektuar me rritje progresive kryesisht në programin e shërbimeve publike. Në total fondi për shpenzimet korente në vitin 2025 është parashikuar me 26% rritje krahasimisht me vitin 2021.

Rritja është e parashikuar kryesisht në shërbimet e pastrimit, grumbullimit dhe pëpunimit të mbetjeve, si një ndër masat më të rëndësishme dhe emergjente në shërbim të sektorit prioritar të Turizmit, dhe për një mjedis në territorin e bashkisë të standarteve europiane në 33% krahasimisht me vitin 2021.

Parashikim në rritje me 23% deri në vitin 2025 ka edhe sektori i turizmit për sa i përket aktiviteteve social kulturore, promovimin Sarandës si një ndër qytetet me premtuese, promotore për industrinë e turizmit në vendin tonë.

Në vëmendje kanë qenë edhe mbështetja **e politikave sociale e përmirësimit të raporteve të barazisë gjinore, për zhvillimin e arsimit, kulturës, sportit etj.** Synimi në angazhimin e kryerjen e shpenzimeve publike për periudhën afatmesme **2023-2025** mbetet **rritja e efikasitetit dhe efektivitetit** të përdorimit të tyre. Niveli absolut i këtyre shpenzimeve në vitin 2022 është **22 %** më i lartë se fakti i vitit 2021. Në programet e njësitë shpenzuese vendore, niveli i shpenzimeve korente, **është mbajtur në limite të kontrolluara**. Në strukturën e shpenzimeve publike, në vitin 2025, ato përbëjnë **22 %** të shpenzimeve korente gjithësej. Kjo është një garanci për një cilësi e standart jetese më të avancuar në vitet që vijnë, për rritje të aksesit të banorëve ndaj shërbimeve të pastrimit, ndriçimit, gjelbrimit, mjedisit si dhe, të shërbimeve në sektorët social të arsimit, kulturës, etj. Nga analiza e strukturës së fondeve të angazhuara në nivel programi ka balancë të qëndrueshme e akses në rritje të banorëve ndaj shërbimeve jetësore, duke u dhënë prioritet shpenzimeve, për shërbime sociale e për shtresat në nevojë.

II.2 Shpenzimet Kapitale

Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si i vetmi instrument për realizimin e Planit të Përgjithshëm Vendor ka nxitur Bashkinë, që të kryej një llogaritje më të mirë midis angazhimeve afatgjata dhe mundësive afatmesme, për të krijuar mundësinë e realizimit PPV, dhe për të mënjeluar çekuilibrat fiskal. Bazuar në objektivat afatmesme të bashkisë dhe potencialin fiskal janë parashikuar zhvillimi i projekteve të investimeve prioritare:

- 1- Rehabilitimi i kanalit ujtes Ksamil, në vlerën **41,455 mije lek**,
- 2- Ndertimi i rruges së 40 Shenjtoreve, në vlerën **119,900 mije lek**
- 3- Ndertimi i Rruges nr.6 **105,000 mije lek**
- 4- Rehabilitimi i kolektorit në shetitoren N. Frasheri në vlerën **20,000 mije lek**
- 5- Rikonstruksioni i ujesjellesit Ksamil në vlerën **158,079 mije lek**
- 6- Furnizimi me ujë zona L.dardhes në vlerën **129,169 mije lek**
- 7- Perfundimi dhe venia në shfrytëzim i Eko Kampus në vlerën **50,000 leke**.

Për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm e në gjithë territorit të bashkisë janë vendosur prioritetet në parashikimin e projekteve për investime. Me prioritarre janë vazhdimi i investimeve në proces, zhvillimi i projekteve me impakte të ndjeshme e të prekshme nga komuniteti kryesisht në infrastrukturen rrugore duke ndërtuar rrugë të reja për të bërë të mundur lehtësimin e trafikut kryesisht në

periudhen e sezonit turistik. Nder prioritetet ka qene dhe vazhdon te jete permiresimi i rrjetit te ujit te pijshem dhe kanalizimeve te ujrave te zeza, etj. **Në vitin 2025** janë programuar të angazhohen për investime **rreth 82 %** e burimeve vendore gjithësej.

Ne parashikimin e investimeve per projektete financuara nga buxheti i shtetit, nuk jane te perfshira investimet qe ka perfituar dhe perfiton aktualisht Bashkia Sarande, por qe investimi kryhet nga FSHZH dhe Ministria e linjes, si ne rastin e **shetitores " Naim Frasheri"** edhe te rruges **nr.1 Lekurs** qe eshte ne proces e siper per te realizuar. Projekti i paraqitur nga Bashkia per financim, dhe shume te deshiruar nga komuniteti dhe nga nevojat e shtuara per infrastrukture ne zonat e reja urbane do behet realitet fale financimit te qeverise kete vit. **Programi i investimeve kapitale**, përgjithësisht është **projekt paraprak**, me më pak ndryshime e përshtatje nga drafti i miratuar nga Këshilli Bashkiak. **Fondet** për investimet publike janë angazhuar në nivele optimale, në programet buxhetore afatmesëm 2023-2025, duke bërë disa përmirësime e përditësime në projektet më të rëndësishme zhvillimore vendore. Ndarja ne projekte brenda nje programi nga te ardhurat vendore, behet ne buxhetin vjetor te vitit respektiv. Investimet me te ardhurat e veta kryesisht, shtrihen ne brendesi te hapesirave publike ne te gjithe territorin e Bashkise, zonat rurale dhe periferive si edhe mirembajtje te infrastruktures rrugore ekzistuese, permiresimin e strukturave ne ndertesat publike, arsim,sport, kulture dhe administrative.

Niveli i financimit eshte pothuajse linear nga viti ne vit, nisur nga fakti i relaizimt per dy vitet e kaluara, dhe nga prespektiva e financimit te projekteve ne 3 vitet e ardhshme.

Disa nga Projektet me financim nga Buxheti i Shtetit jane:

1. Rehabilitim i kanalit ujites Ksamil , pjesa e pare ,investim qe prej te cilit do te perfitojne pjesa me e madhe e fermereve te zones Cuke – Ksamil.Rikonstruksion I ujsjellesit Ksamil(Depo+rrjet shperndares ne lagjen nr 3 dhe 4) do te shtrihet ne zonen me problematike te Ksamilit duke zgjidhur keshtu problematiken e shume viteve te ujit.
2. Rehabilitimi I kolektorit te UZ ne shetitoren N.Frasheri, do te behet ne trupin e shetitores, dhe do te sherbeje per rritjen e kapacitetit te shkarkimit te UZ duke zgjidhur nje problematike shumevjecare te lagjeve periferike te Sarandes.
3. Furnizimi me ujë zona periferike Lugu I Dardhë&B.Rexhepi . Ky investim konsiaton ne ndertimin e rrjetit shperndares te ujit te pijshem dhe do te vere ne funksion depon e furnizimit me uje e ndertuar rreth 6 vite me pare dhe nuk eshte vene ne eficence.
4. Perfundimi I projektit te , Eko-Kampusi arsimor, faza II., synon perfundimin e ketij projekti dhe venien ne eficence te ketij investimi te nisur ne vitin 2015 me financim te Buxhetit te shtetit.

Grafiku 5. Ecuria e transfertes se kushtezuar per investimet ne periudhen afatmesme.




Tabela 9. Ecuria dhe parashikimi afatmesem per Investimet Kapitale

Emri i Artikullit	Emri i Programit	Emri i Projektit	Kosto Totale e Projektit	Burimi i Financimit	2020	2021	2022	2023	2024	2025
					Fakt	Fakt	Plani	Plani	Plani	Plani
1110	Planifikim, Administrim Menaxhim	Investime me fonde te brendshme	86,448	Buxheti i Bashkise		960	2,000	7,379	9,500	25,000
	Shuma					960	2,000	7,379	9,500	25,000
3280	Sherbimi zjarrfikës	brendshme	9,000	Buxheti i Bashkise			2,000	3,500	3,500	8,000
	Shuma		9,000				2,000	3,500	3,500	8,000
4240	Bujqesia dhe peshkimi	Rehabilitim i kanalit ujtes Ksamil , pjesa e pare	41,455	Buxheti i shtetit		13,597	27,858			
	Shuma				13,597	27,858	-	-	-	-
4570	Infrastrukture dhe transport rrugor	Ndërtim i Rruges H.Freskia-Manastiri 40 Shenjtoret	756,795	Buxheti i shtetit				69,500	25,400	25,000
4570	Infrastrukture dhe transport rrugor	Ndertimi i Rruges nr.6	608,000	Buxheti i shtetit				25,000	40,000	40,000
4570	Infrastrukture dhe transport rrugor	Investime ne infrastrukturen rrugore		Buxheti i Bashkise	96,598	121,408	98,997	93,360	92,000	104,956
	Shuma		1,364,795	-	96,598	121,408	98,997	187,860	157,400	169,956
6260	Sherbime publike Vendore	Investime me fonde te brendshme		Buxheti i Bashkise	30,290	8,320	93,728	75,884	95,000	102,000
	Shuma				30,290	8,320	93,728	75,884	95,000	102,000
6330	Furnizimi me ujë,KUZ.	Rehabilitimi i kolektorit te UZ ne shetitoren N.Fraseri	20,000	Buxheti i shtetit			20,000			
6330	Furnizimi me ujë,KUZ.	Rikonstruksion i ujsjellesit Ksamil(Depo+rrjet shpermdares ne lagjen nr 3 dhe 4	158,079	Buxheti i shtetit		70,200	20,200	67,679		
6330	Furnizimi me ujë,KUZ.	Furniz.me ujë zona periferike L.Dardhë&B.Rexhepi	129,169	Buxheti i shtetit		28,386	83,917	25,455		
6330	Furnizimi me ujë,KUZ.	brendshme		Buxheti i Bashkise	8,490				80,306	10,000
	Shuma		307,248	-	8,490	98,586	124,117	93,134	80,306	10,000
8130	Programe Kulturore dhe sporti	Investime me fonde te brendshme	26,175	Buxheti i Bashkise	2,803	1,872	3,000	7,500	11,000	12,368
	Shuma			-	2,803	1,872	3,000	7,500	11,000	12,368
9120	Arsimi Parauniversitar	Ndërt.shk. 9 vjeçare, Eko-Kampusi arsimor, faza II.	132,500	Buxheti i shtetit	11,375			50,000		
9120	Arsimi Parauniversitar	Investime me fonde te brendshme		Buxheti i Bashkise	33,432		11,302	14,000	14,000	20,000
	Shuma		132,500	-	44,807	-	11,302	64,000	14,000	20,000
9230	Arsimi i mesem I pergjithshem	Investime me fonde te brendshme		Buxheti i Bashkise			2,500	2,500	2,500	
	Shuma			-	-	-	2,500	2,500	2,500	-
9240	Arsimi i mesem profesional	Investime me fonde te brendshme		Buxheti i Bashkise			3,500	3,550	3,550	3,400
	Shuma			-	-	-	3,500	3,550	3,550	3,400
10140	Sherbimi Social	Investime me fonde te brendshme		Buxheti i Bashkise	4,853					6,000
	Shuma			-	4,853	-	-	-	-	6,000
	TOTALI			-	187,841	244,743	369,002	445,307	376,756	356,724

II.3 Shpenzime per personelin

Pjesë e rëndësishme e programit afatmesëm 2023-2025, është edhe **numri i punonjësve** të administratës, të njësive shpenzuese në varësi dhe i funksioneve specifike.

Burimet njerezore jane aset me i rendesishem ne veprimtarine e Bashkise prandaj vemendje te vecante merr parashikimi i fondeve per pagat, trajnimin e tyre , kualifikimet e nevojshme, dhe ne sektoret qe ka nevojte per shtese te numrit te punonjesve te realizohen. Kjo ben qe funksionet e sektoreve te vecante por edhe ne teresine e funksionimit te pushtetit

vendor te behet me efektiv dhe cilesisht i rritur. Pushteti vendor per burimet njerezore ka si synim realizimin e objektivave te meposhtme:

- ✚ Rritjen e efijencës dhe e performancës së strukturave organizative.
- ✚ Përmirësimin e procedurave dhe respektimin e afateve proceduriale per punonjesit.
- ✚ Përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.
- ✚ Koordinimin e administrimit territorial.
- ✚ Realizimin e plotë të objektivave.
- ✚ Maksimizimin e luftës kundër evazionit fiskal.

Në strukturen organike te Bashkisë së Sarandes perfshire edhe njesite e varesise dhe Njësine Administrative do të shtohen në total 7 punonjës ne periudhen afat mesme 2023-2025. Efektet financiare pas miratimit të shtesës në numrin e punonjësve per vitet buxhetore perkatese do te reflektohen ne buxhet.

Rritja eshte parashikuar ne sektorin e Sherbimeve Publike, per te siguruar fuqine punetore te nevojshme per te mbuluar te gjitha natyrat e puneve publike dhe nevojave per rritje cilesore te sherbimeve nga ana e populates. Kerkesa ne rritje ka edhe sektori i Arsimit parashkollor, kryesisht per edukatore mbeshtetes per femijet me aftesi te kufizuara.

Për sa më sipër, për mbarëvajtjen e kërkesave dhe funksioneve të shtuara në të gjitha drejtoritë, për burime njerëzore, për përpunimin e të dhënave dhe treguesve statistikore për personel të kualifikuar në sektorin e shërbimit dhe sektoreve te tjere publike, si rezultat i volumeve të shtuara të punës , ne vazhdimesi evidentohet domosdoshmëria e riorganizimit të punës e pasqyruar kjo edhe ne strukturen organike te Bashkise.

Tabela 10. Numri i Punonjesve sipas programeve buxhetore

Ndryshimi I numrit te punonjesve ne periudhen afatmesme							
	Fakti	Fakti	Fakt	Parash.	Parash.	Parash.	Parash.
Emërtimi Programit	V.2019	V. 2020	V. 2021	V. 2022	V. 2023	V. 2024	V. 2025
Punonj administ qëndrore e të njësive në varësi	292	294	296	308	311	313	315
Punonjës të funksioneve specifike	112	113	114	122	122	122	122
TOTALI	404	407	410	430	433	435	437

Për Programin afatmesëm 2023-2025 social e barazinë gjinore.

Në këtë Program Buxhetor Afatmesëm janë përcaktuar dhe do të ndermerren hapa konkrete në zbutjen e pabarazisë gjinore, për të synuar në një periudhë relativisht të afert **barazinë gjinore. Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm**, janë parashikuar të zgjidhen disa prej kërkesave specifike që lehtësojnë ngarkesën e grave në veprimtarinë e përditshme. Politikat afatmesme orjentohej dhe fondet destinohen me fokus, të zgjidhjes së problemeve të ndryshme gjinore e veçanërisht në përmirësimin e infrastrukturës urbane e të asaj sociale, duke u siguruar grave akses në rritje ndaj shërbimeve të ndryshme jetësore.

Tavanet dhe nivelet orjentuese, të pasqyruara në draft-programin e paraqitur, janë përgjithësisht detyruese. Ato do shërbejnë si bazë referuese për përgatitjen e kërkesave dhe të **kuotave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe të përgatitjes së buxhetit vjetor 2023**. Miratimi nga Këshilli Bashkiak, në zbatim të **Ligjit nr.68, datë 27.04.2017**, për financat e vetëqeverisjes vendore si edhe “ UMF nr 8, datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, për **Përgatitjen e PBA Vendor 2023-2025** , u krijon njësitë shpenzuese të varësisë dhe vetë ekzekutivit vendore, terrenin dhe hapesirat e nevojshme për të parashikuar alternativat e objektivat në programin zhvillues afatmesëm 2023-2025.

Projekti Buxhetor Afatmesëm, do të diskutohet me njësitë shpenzuese të varësisë të Bashkisë Sarandë, komunitetin vendor dhe grupet e interesit, për të mundësuar hartimin e një programi sa më të performuar cilësisht dhe, me synime sa më ambicioze. Draft programi buxhetor paraprak do të *rishqyrtohet* pas opinioneve dhe vërejtjeve nga ana e Ministrisë së Financave, në zbatim të udhëzimit standart nr 23, datë 20.07.2018 për përgatitjen e PBA.

KRYETAR

ADRIAN GURMA

